

Home > Aktualitet > Sulmi me armë në Shkodër! Arrestohen dy vëllezërit Doçi, dëshmia e tyre: Qëlloi drejt

AKTUALITET

Sulmi me armë në Shkodër! Arrestohen dy vëllezërit Doçi, dëshmia e tyre: Qëlloi drejt nesh në mënyrë të papritur, nuk kemi asnjë konflikt

Dy vëllezërit e plagosur në deklarinimin për policinë kanë thënë se nuk kemi asnjë konflikt dhe nuk e kemi idenë përse na ka qëlluar personi tjetër dhe madje nuk e njohim se kush ka qenë.



Foto ilustruese

21 Mars, 2021 12:56

SHKODËR– Policia ka arrestuar dy shtetasit e plagosur mbrëmjen e kaluar në fshatin Bardhaj të Shkodrës, Marjan Doçi 23 vjeç dhe Hoten Doçi 30 vjeç.

Arrestimi i tyre është bërë në kushtet spitalore teksa ndodhen në Spitalin e Traumës në Tiranë jashtë rrezikut për jetën nën mbikëqyrje nga forcat e policisë. Nga ana tjetër po mbrëmë policia ka identifikuar autorin e dyshuar shtetasin Besmir Perkola, i cili ka lënë të plagosur dy vëllezërit Doçi, i cili është shpallur në kërkim.

Dy vëllezërit e plagosur në deklarinimin për policinë kanë thënë se nuk kemi asnjë konflikt dhe nuk e kemi idenë përse na ka qëlluar personi tjetër dhe madje nuk e njohim se kush ka qenë.

“Ishim tek makina kur një person u afrua dhe qëlloi drejt nesh në mënyrë të papritur. Nuk e kemi idenë përse na ka qëlluar sepse nuk kemi ndonjë konflikt”, mësohet të kenë thënë dy vëllezërit për policinë.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Policia e Shkodrës vijon hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje si dhe vijon puna për gjetjen dhe kapjen e autorit të dyshuar Besmir Perkola. Që mbrëmë por edhe gjatë ditës së sotme një grup i Forcave të Ndërhjryes së Shpejtë ka qëndruar në vendin ku ndodhi plagosja për të shmangur çdo lloj konflikti tjetër pasi të dy familjet jetojnë afër njëra-tjetrës.

NJOFTIMI I POLICISË:

Vihen në pranga dy vëllezërit Doçaj që mbetën të plagosur mbrëmjen e djeshme gjatë një konflikti me armë zjarri. Shpallet në kërkim autori i plagosjes së dyfishtë me armë zjarri. Në vijim të veprimeve për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e djeshme në fshatin Bardhaj, në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve M. D., 26 vjeç dhe H. D., 31 vjeç, banues në fshatin Bardhaj, Shkodër, si dhe u shpall në kërkim shtetasi B. P., 29 vjeç, banues në fshatin Bardhaj, Shkodër. Nga veprimet hetimore rezultoi se: Më datën 20.03.2021 rreth orës 19.30, në fshatin Bardhaj Shkodër, gjatë një konflikti për motive të dobëta shtetasit M. D. dhe H. D. kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit B. P. i cili i është kundërpërgjigjur duke qëlluar me armë zjarri automatik, ku për pasojë mbetën të plagosur jashtë rrezikut për jetën dy vëllezërit ndërsa shtetasi B.P., u largua nga vendi i ngjarjes dhe u shpall në kërkim. Vijon puna intensive për kapjen e shtetasit B.P. Në vendin e ngjarjes janë sekuestruar prova materiale që shërbejnë për dokumentimin e plotë të ngjarjes si dhe mjeti tip Audi, i shtetasit M.D. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër në ngarkim të shtetasve M. D. dhe H. D. për veprat penale “Vrasje me paramendim, e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë”, si dhe “Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, ndërsa për shtetasin B. P. për veprat penale të “Vrasje në rrethana cilësuese, e mbetur në tentativë”, dhe “Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”.

(A.B)/Dosja.al

ETIKETA: [#besmir perkola](#) [#Hoten Doci](#) [#Marjan Doçi](#)

2 SHARES [f](#) [t](#) [t](#) [G+](#) [p](#) [w](#) [v](#) [e](#)

Previous article
VIDEO/ E tërheqin zvarrë, policia dhunon dhe shtrinë në tokë qytetarin në mes të Tiranës

Next article
Ekzekutimi i Edmond Koçit në Durrës, ngrihet grupi hetimor! Katër persona morën pjesë në vrasje, u paguan për të eliminuar “Mond Çekiçin”

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo


POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet




LAJM I MIRË/ 19-vjeçarja e infektuar me Covid sjell në jetë foshnjën e saj, mjekja Cani:...

Aktualitet




FOTO/ Rikthehet dëbora, zbardhet Pogradeci, pamje nga Qafë-Pilloga

Aktualitet



Ekzekutimi i Edmond Koçit në Durrës, ngrihet grupi hetimor! Katër persona morën pjesë në...

Aktualitet



VIDEO/ E tërheqin zvarrë, policia dhunon dhe shtrinë në tokë qytetarin në mes të...



STAY CONNECTED

[f](#) | Facebook | LIKE

[t](#) | Twitter | FOLLOW

[i](#) | Instagram | FOLLOW

[v](#) | Youtube | SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



21 Mars, 2021 15:39

Shehi: “Kishim një skuadër shumë të fortë përball, por ja dolëm”



21 Mars, 2021 15:35

Josa: “Luajtëm, por në këtë ndeshje ishim të pafat”



21 Mars, 2021 15:34

E krahasoi me Kushin, Idrizi i përgjigjet Ramës: Haxhi Qamili me 3 klasë Teknikumi Piktura do mbahet mend si kryeministri që hoqi emrin e Çamërisë nga librat, dhe nxorri në protestë studentët



21 Mars, 2021 15:32

“Premtime me përralla”, Grida Duma publikon videon e Ramës: Në mandatin e tretë do përfundojmë katër aeroporte

